REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke e konsideruar AKEP-in si një institucion, i cili mbikëqyr sektorë shumë të specializuar me një zhvillim të vazhdueshëm e dinamik siç janë komunikimet elektronike dhe shërbimet postare;
- Duke pasur parasysh se një nga objektivat rregullatore të AKEP-it është mbrojtja e interesave të përdoruesve dhe sigurimi i përfitimeve maksimale nga aksesi në shërbimet e komunikimeve elektronike;
- Duke pasur parasysh rolin e AKEP-it në promovimin e konkurrencës në rrjetet e komunikimeve elektronike, veçanërisht në garantimin që përdoruesit të përfitojnë maksimalisht nga këto shërbime;
- Duke pasur parasysh që AKEP-i ka rol të rëndësishëm në inkurajimin e përdorimit dhe menaxhimit efiçent të radio frekuencave dhe të serive numerike;
- Duke pasur parasysh që rritja e konkurrencës në treg, vazhdimi i reduktimit të tarifave të terminimit midis operatorëve, si edhe efekti pozitiv i procesit të bartjes së numrit celular, ka sjellë reduktim të vazhdueshëm të tarifave të shërbimeve celulare;
- Duke pasur parasysh punën e AKEP-it për përmirësimin e sistemeve informatike dhe implementimin e shërbimeve on-line;
- Duke vlerësuar që penetrimi i telefonisë fikse vazhdon të mbetet shumë i ulët;

Konstaton se AKEP-i për vitin 2012:

- Ka vazhduar ofrimin dhe dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të standardit 3G edhe për një tjetër operator.
- Ka punuar në ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve informatike për arritjen e objektivit në kalimin në e-Authority, ofrimin on-line të shërbimeve për konsumatorët e tij, si edhe dixhitalizimin e proceseve të brendshme të përpunimit të informacionit.
- Ka vazhduar të punojë për reduktimin e tarifave të aksesit broadband në internet.
- Ka përgatitur studimin e brezave VHF/UHF në bashkëpunim me institucionet e tjera, i cili do të bëhet efektiv për hartimin e Planit të ri të Përdorimit.
- Ka kryer monitorimin e mbulimit me sinjal dhe treguesve të cilësisë për shërbimet GSM/UMTS në të gjithë rrugët nacionale.
- Ka miratuar rregulloren RUO për Albtelekom.
- Ka hartuar rregulloren për transparencë të tarifave dhe kushtet e ofrimit të shërbimit nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, gjë që mundëson qartësimin e përdoruesve në lidhje me shërbimet e komunikimeve elektronike.
- Ka punuar për plotësimin normativ të kuadrit rregullator në sektorin e komunikimeve elektronike në zbatim të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

- Ka punuar në rritjen e performancës dhe efektivitetit në realizimin e treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
- Ka bërë një monitorim më të hollësishëm lidhur me ofrimin e shpejtësisë së internetit nga operatorët.
- Nuk ka përfunduar studimin mbi Sistemin Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave.
- Nuk ka plotësuar kuadrin rregullator për tregun postar.
- Ka vazhduar të punojë, por nuk ka përmbushur implementimin e shërbimit universal.

Kërkon nga AKEP-i për vitin 2013:

- Të angazhohet vazhdimisht në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për rritjen e fleksibilitetit, efektivitetit dhe transparencës së ofrimit të shërbimeve të tij;
- Të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për të garantuar kushtet e një konkurrence të ndershme në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare;

- Të angazhohet në implementimin e shërbimit universal bazuar në zgjidhjet e tregut, parimin e proporcionalitetit, reflektimin e statusit kombëtar të sektorit, si dhe sigurinë ligjore dhe korrektësinë procedurale;

- Të angazhohet vazhdimisht në uljen e mëtejshme të tarifave të shërbimeve të ofruara në tregun e komunikimeve elektronike;

- Të vazhdojë të angazhohet në administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave;

- Të vazhdojë të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse;

- Të vazhdojë të angazhohet në plotësimin e kuadrit rregullator për funksionimin e tregut postar;

- Të angazhohet në kryerjen e analizave të tregut në ofrimin e shërbimeve linja me qira dhe aksesi broadband;

- Të vazhdojë të angazhohet në plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të ndryshimeve të ndodhura në legjislacionin parësor për komunikimet elektronike;

- Të vazhdojë të angazhohet në miratimin dhe implementimin e rregullave për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (AS/CA-Account Separation/Cost Accounting) për operatorët FNT;

- Të angazhohet në miratimin dhe implementimin e ndryshimeve në planin kombëtar të numeracionit;

Miratuar në datën 2.5.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)